

AIO

---

192

Edmond Çali

Intervistë me  
Kasëm Trebeshinën



Copyright © MMVI  
Edmond Çali

\* \* \*

ARACNE editrice S.r.l.

[www.aracneeditrice.it](http://www.aracneeditrice.it)  
[info@aracneeditrice.it](mailto:info@aracneeditrice.it)

via Raffaele Garofalo, 133 A/B  
00173 Roma  
(06) 93781065

ISBN 88-548-0672-2

*I diritti di traduzione, di memorizzazione elettronica,  
di riproduzione e di adattamento anche parziale,  
con qualsiasi mezzo, sono riservati per tutti i Paesi.*

*Non sono assolutamente consentite le fotocopie  
senza il permesso scritto dell'Editore.*

I edizione: giugno 2006

## Parathënie

Kjo intervistë me Kasëm Trebeshinën është vetëm njëra prej bisedave që kam bërë me të gjatë viteve të fundit. Këtu Trebeshina flet për veprën e tij në përgjithësi, për disa vepra të veçanta, për letërsinë shqiptare dhe historinë e saj. Vepra e Trebeshinës, pjesë e së cilës është ende e pabotuar, po vendos një ekuilibër të ri në sistemin e letrave shqipe. Në librat e botuar deri tani kemi disa veçori që përsëriten: tregimin brenda tregimit, ëndrrën, dialogun, brendinë filozofike. Një pjesë e mirë e tregimeve dhe e novelave kanë të njëjtën skemë të ndërtimit strukturor duke na dhënë një përsëritje krijuese që nuk e kishim hasur më parë në këtë nivel në letërsinë shqipe.

Kasëm Trebeshina iu prezantua botës akademike të letrave shqipe këtu në Itali për herë të parë nga Giuseppe Gradilone në vitin 1997 me shkrimin “Un profilo inedito di Kasëm Trebeshina” (botuar në “Studi di letteratura albanese contemporanea”, Romë, 1997, ff. 265-279).

Veprat që citohen gjatë intervistës janë:

Kasëm Trebeshina:

- “Koha tani Vëndi këtu”, Tiranë, Shtëpia botuese Arbëria, 1992, ff. 109;

- “Legjenda e asaj që iku”, Tiranë, Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1992, ff. 277;

- “Mekami”, Prishtinë, Ndërmarrja Botuese “Gjon Buzuku”, 1994, ff. 103;

- “Ku bie Iliria?”, Tiranë, Toena, 2000, ff. 253;

- “Hijet e shekujve”, Tiranë, Eurilindja, 1996, ff. 291;

- “Kënga shqiptare”, Tiranë, Globus, 2001, V. I, ff. 342, V. II, ff. 339, V. III, ff. 353, V. IV, ff. 354, V. V., ff. 356;

- “Dy të humburit”, në “Ars”, nr. 1 (11), Tiranë 26 janar 2003, ff. 8-12;

- “Dafina të thara”, përfunduar së shkruari në vitin 1998, ff. 165, i pabotuar.

Dhurata Shehri, “‘Odin Mondvalseni’ i Kasëm Trebeshinës”, në MM, 1996, nr. 5;

Edmond Çali, “‘Lulja e Kripës’, Fëmijëria, mosha e parapëlqyer nga letërsia e Nëntëqindës”, në “Romanet e Jakov Xoxës”, Tiranë, 2003, ff. 40-56.

Edmond Çali, “Një ambasadë e zulluve në Paris”, në “Faik Konica (1876-2004)”, Tiranë, 2004, ff. 56-63.

Intervistën e kam regjistruar më datë 3 nëntor 2002 në banesën e Kasëm Trebeshinës në qendër të Tiranës.

Po e botoj me rastin e tetëdhjetëvjetorit të shkrimtarit tonë të madh.

Edmond Çali

Romë, maj 2006.

Edmond Çali: Nga *Dafina të thara. Romani i jetës sime* mësojmë se keni filluar të shkruani në moshën njëmbëdhjetëvjeçare. Duke llogaritur edhe pjesën e pabotuar të veprës Suaj, prodhimtaria Juaj latrare nuk mund të krahasohet me atë të asnjë shkrimtari tjetër shqiptar për nga ana sasiore dhe për fushat e saj. Ndoshta vetëm me atë të De Radës. Cila është baza, tradita ku Ju mbështeteni? Ju thoni se baza Juaj është një trekëndësh...

Kasëm Trebeshina: Parashkuesit, për mua bazë është Dantja. Edhe Mikelanxhelo. Nga mënyra se si kompozojnë ata. Ajo është baza e ime. Pas tyre unë mbështetem tek trekëndëshi i Rilindjes Evropiane: Servantes, Rabële, Shekspir. Domethënë unë këtë e kam quajtur *realizëm poetik*, fillimisht. Më vonë këtë e quajta *realizëm simbolik*. Por gjithmonë mbi bazën e një realizmi. Jo realizmi i rrugës, jo realizmi i objektivit të aparatit fotografik apo kinematografik. Jo ky realizëm. Një realizëm më lart se ky. Domethënë një realizëm që të jetë më real se vetë realizmi. Mbështetjen tjetër në vazhdim e kam tek Rembrandi edhe tek Gëtja. Duke u mbështetur plotësisht tek ajo që është, unë nisem me rikrijimin e saj. Domethënë: jo ajo që quhet imitim i natyrës, po rikrijim i natyrës. Domethënë jam kundër asaj pengese, imitim i natyrës. Atë, imitim i natyrës unë nuk e pranoj. Natyrën mund ta imitojë plotësisht aparati fotografik. Për ta paraqitur atë që dua unë më saktë, unë nuk nisem nga përshkrimi i të tërës, por marr një detaj të saj. Një detaj që për mua është në gjendje ta përfaqësojë të tërën, dhe me anë të tij, të atij detaji, unë mbështetem te sinekdoka për të dhënë të përgjithshmen.

E. Ç.: Tregimet e vëllimit *Vendi-këtu, koha-tani* janë tri: “Kohë pa fund. Tregim i një të panjohuri”, “Kukudhi. Tregimi një akinxhiu” dhe “Shkëmbi i mallkuar. Ëndërr e një nate maji”. Në tregimin “Kohë pa fund. Tregim i një të panjohuri” një nga personazhet është komisar kompanie, flitet për luftën. Kjo ka lidhje me autobiografinë Tuaj, me jetën Tuaj: *Në mes të*

*njerëzve, që kishin bërë ato arrestime mizore, isha edhe unë, një komisar kompanie, që akoma nuk i kishte mbushur të tetëmbëdhjetë vjetët (f. 6)?*

K. T.: Këto janë eksperiencia që unë i kam jetuar. Por jo të gjitha unë. Unë kam qënë në luftë. Se unë s'kam qënë komisar kompanie asnjëherë. Unë kam kaluar direkt në komisar bataljoni, dhe në komisar brigade. Kështu nuk kam qënë asnjëherë në rangjet e ulta. Kam qënë në strukturat mesatare. Ai është një personazh. Unë jap atë që mund të jetonte një personazh i moralshëm.

E. Ç.: Në këtë vepër Ju jepni disa nga tiparet e gjithë krijimtarisë Suaj: praninë e fëmijërisë, si një nga temat e parapëlqyera të letërsisë, autobiografinë, ëndrrën, ndërtimin e përsosur strukturor të rrëfimit, tregimin e futur brenda tregimit, ndërtimin e rrëfimit brenda një skeme me kornizë, brendinë e thellë ideore dhe filozofike të shkrimit, ndërthurjen e kohëve. Në ç'kohë jemi? Ju shkruani: *Ti ke të drejtë, aty tashti nuk shihet asnjë zjarr, se mishin e hëngrën qentë, hellin e dogji zjarri, dhe zjarrin e shoi shiu!... Të gjitha këto ndodhën në kohërat që nuk mbahen mend!... Atëherë kur njerzit luftonin kendej dhe në anën e përtejme të detit.* (f.14).

Pastaj kemi edhe në një pikë tjetër. Kemi një refleksion për kohët, e ardhmja, e kaluara: *Nuk mund të kuptohej në ishte e kaluara që vinte të na takonte, apo e ardhmja zvarritej atje, diku pas nesh në thellësitë e shekujve?!... (f. 21).* Koha, edhe kur jepet, është e papërcaktuar: *Nuk e dija çfarë dite ishte, por shiu dëshmoi për këmbimin e stinëve.* (f. 24).

Koha, kjo është për mendimin tim, koha e letërsisë Suaj, apo jo? Koha në të cilën Ju keni vendosur letërsinë.

K. T.: Koha në të cilën e kam vendosur unë është e kushtëzuar nga letërsia.

E. Ç.: Po. Pastaj, përse i përket një elementi tjetër. Shikoj këtu që shpesh, qoftë në tregimet e shkurtra, qoftë në ato pak më të

gjata keni një rrap të moçëm, keni një plak, i cili nganjëherë paraqitet me një mjekër gri në të gjelbër, nganjëherë me një ngjyrë tjetër të mjekrës. Ç'është kjo? Një simbol? Diçka për të dhënë traditën? Apo lexuesi dhe kritiku i sotëm duhet ende të presë që të zbulojë që të gjithë gurët e mozaikut të sistemit të veprës Suaj latrare?

K. T.: E di si është puna? Çdo studjues i veprës time tashti për tashti e ka të pamundur t'i bëjë studimin. Pse? Sepse unë jam një autor i pabotuar, nga njëra anë. Dhe një autor që shoqëria shqiptare mundohet ta zhdukë, aq sa mundet, pjesërisht, apo tërësisht. Kjo është një nga arsyet e mosbotimit. Duhet të dihet se cilat janë konceptet e mia. Një studiues serioz që do t'i hyjë veprës sime pa njohur tërësinë e saj, *Brenda çastit kozmik*, pa njohur *Ylberin*, pa njohur *Spiralen e madhe të universit*, nuk mund të hyjë në të. Se unë me të vërtetë shumëkohësinë e kam marrë nga Dantja dhe Dantja e ka marrë nëpërmjet Virgjilit; është nga Odiseja e Homerit ajo shumëkohësi. Mirëpo Dantja na e jep në një mënyrë të tij krejt të re, në mënyrë krejt të re dhe këtu qëndron madhështia e tij: që kapen të tërë kohët e reja. Ai është paralajmëruesi. Është babai i tërë kohëve të reja. Kështu që nuk është thjesht shumëkohësia e marrë në letërsi gjatë traditës, domethënë lidhja ime me këta. Por është edhe koncepti i im për këtë. Për mua në kozmos, në hapësirat e padukshme, në hapësirat ku mendja e njeriut nuk arrin, edhe nuk mund të arrijë, atje janë të gjitha këto. Ato që konceptojmë ne, dru, gur, njeri, e mira, e liga, moralja, antimoralja. Ç'janë, të gjitha, të gjitha janë atje. Të gjitha sa vijnë këtu marrin një formësim, egzistojnë atje. Të gjitha këto koncepte që bëjmë ne t'i njohim, edhe në një panumërsi të tillë që ne nuk do ta njohim kurrë. Këto janë atje dhe formojnë ato formësi që unë i quaj formësi kozmike, që janë atje, që vijnë këtu, japin në mënyrë sporadike këtu ca *spazi di luce* që i shohim ne dhe bëjmë sikur i dimë. Por njohja kurrë nuk do të ketë fund. Dhe ne kurrë nuk do të jemi në gjendje të njohim. Dhe kthehen përsëri atje ku ishin, tek përjetësia. Vijnë këtu dhe ikin. Kështu që këtu, qoftë guri, qoftë druri, unë i ndaj në cikël: qenie të lëvizshme edhe qenie të fiksuara. Guri, për



shembull, lëvizshmërinë e tij e ka shumë më të qetë dhe minimale se sa druri. Kurse kafshët, mbasandaj, ndahen edhe ato në kategoritë e tyre.

E. Ç.: Për shembull:...

K. T.: Prandaj këtu qëndron edhe vështirësia. Tek *Ylberi* unë e përcaktoj këtë. Përcaktoj edhe gjashtëmijëvjeçarin që jetojmë ne. Edhe për mua fillon degjenerimi. Ka 200 vjet që ka filluar rënia e njeriut. Tashti të gjitha këto nuk mund të shpjegohen vetëm thjesht: Letërsinë, kapet ajo; këtu është simbolizmi, këtu është tradita. Këtu është kjo. Këtu është ajo. Që të hyet tek njohja duhet të njihet tërë teoria e njohjes. Duhet të jenë të botuara të paktën të nëntë pjesët, minimumi, të nëntë pjesët e *Brenda çastit kozmik*. Atëhere, po. Dhe në mënyrë të veçantë duhet *Ylberi* që është i fundit. Se unë kulturën njerëzore, këto suksese, që na duket sikur kemi arritur suksese të mëdha këto gjashtëmijë vjet janë që fillojnë me vetëdije, me moralin, me fenë... të gjitha këto janë tamam një ylber mbi kozmos, që s'egziston. Prandaj them që në këtë drejtim, në qoftë se ne do të thellohemi, do të ishte e pamundur. Se do të ishte e pamundur edhe nga pikëpamja letrare. Pa njohur *Meteoritin e Kotvanit*, pa njohur, bie fjala, *Tre net në Odërras*, pa njohur *Aventurat e Rrakatakes në Odërras dhe jashtë*,... janë disa romane.... nuk mund të flitet për prozën time, akoma, a më kupton? Për shembull, ke romanin e fundit *Lajthitja e perëndive*. Pa njohur atë roman, nuk mund të njohësh konceptet e mija letrare. Është e vështirë. Do bëjmë përcaktime të përgjithshme teorike. Një herë do pasur parasysh kjo: nga pikëpamja filozofike, për njohjen: njohja është e pamundur. Ne gjërat i njohim vetëm duke krijuar disa kushtëzime. Edhe prej tyre disa kushte. Dhe t'i kishim dhe t'i bëjmë, dhe shërbehemi prej tyre. Por jo të gjitha sa ne i quajmë për shkencë janë të vërteta. Janë vetëm kushtëzimet tona që na shërbejnë në atë që kërkojmë ne të bëjmë. Prandaj është i vështirë studimi im... Se ti merr një auktor... filanin... Auktor Filani është i botuar, mor xhan. Ai është botuar pa arritur 76 vjeç që jam unë. Dhe është i botuar.